- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2018, 2019, 2020 të konfirmuar nga administrata tatimore.
- 2.2.2 Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore të realizuar në tre vitet e fundit 2018, 2019, 2020 e cila duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se 50 % e fondit limit objekt prokurimi.
- 2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020, dhe për vitin e fundit 2021 (**këstet e maturuara**), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, prane njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit në QKB.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike këto kritere plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

2.3 Per kapacitetin teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Pika 2.3.1 gërma a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1 gërma b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

1.Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim.

Ose

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/indokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Lejen e Ndertimit
4. Situacionin përfundimtar të objektit;
5. Akt kolaudimi objekti;
6. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh duhet të paraqitet si vijon:

- Kontrata e Bashkim Operatoresh deklaruar në fazën e tenderimit
- Prokura e posacme e Bashkim Operatoresh deklaruar në fazë tenderimi

Në rast se kontrata e paraqitur është realizuar si Nënkontraktor duhet të paraqitet si vijon :

- Kontrata bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor
- Miratimi zyrtar si nënkontraktor zyrtar nga ana e autoritetit kontraktor
- Formularin e vlerësimit sipas shtojcës Nr.9 nga ana e autoritetit kontraktor që vërteton se operatori ekonomik është nënkontraktor i deklaruar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë ku përfshihen.

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

1. NP– 1 A Punime gjurmimi në tokë
2. NP– 2 A Ndërtime Civile dhe industriale
3. NP– 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
4. NP– 7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje
5. NP– 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

1. NS– 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
2. NS– 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
3. NS– 18 A Punime topogjeodezike

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

2.3.3 Staf kryesor dhe mbështetës, punonjësit, liçencimet, certifikimet.

a. Operatori/et ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë inxhinierët e mëposhtëm:

1) Inxhinier Ndërtimi (Profili i Përgjithshëm)	1 (një)
2) Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport)	1 (një)
3) Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
4) Inxhinier Mjedisit	1 (një)
5) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder	1 (një)
6) Inxhinier Mekanik	1 (një)
7) Inxhinier Gjeolog	1 (një)

- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimalisht në 6 muajt e fundit.

Për secilin inxhinier drejtues teknik duhet të paraqiten:

- Kontratë pune noteriale e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të pakten gjashtë muajt e fundit në të cilat inxhinierët e sipërmendur duhet të figurojnë.
- Dëshmi të Sigurimit Teknik për secilin inxhinier të lëshuar nga ISHTI ose nga një trup certifikues dhe akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Per Inxhinierin e Mjedisit duhet te paraqitet edhe:

- Certifikata për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.
- Certifikate si “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Per te pakten njerin nga inxhinieret drejtues teknik te paraqitet:

- Certifikata si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier".

Per te pakten njerin nga inxhinieret drejtues teknik te paraqitet:

- Certifikata për “Ekspert Privat Zjarrfikës” në fushën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin, lëshuar nga drejtoria e PMZSH-së, ose nga shoqëri të akredituara ose organizma ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kriteret plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

- b. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe në rast se shpallet/en fitues për këtë procedurë do të qëndrojnë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.**
(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit)

- c. **Shoqëria, përveç stafit drejtues, duhet te kete staf të kualifikuar te inxhinierëve për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt:**

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi (Profili Strukturist)
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Pyjesh

Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit te larte.
- Dëshmi te Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga nje trupe çertifikuese e akredituar ne Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.
- Listepagesat e shoqërise per te pakten gjashte muajt e fundit ne te cilat inxhinieret e siperpermendur duhet te figurojne.

Për Inxhinierin e Pyjeve duhet të paraqiten dhe certifikatat:

- Per “Sherbime profesionale per projekte. Sherbime profesionale per zbatime” leshuar nga Ministria e Mjedisit.
- Certificate si “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

d. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar minimalisht:

- 2 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) prej inxhinierëve të shoqërisë të pajisur me “Certifikatën e Audituesit Energjitik” në instalime industriale, lëshuar nga Agjencia për Eficensën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.
- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë formimi profesional “Laborantë të Produkteve të Ndërtimit” lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për secilin punonjës duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diplomë/certifikatë
- Listepagesat e shoqërise për të pakten gjashtë muajt e fundit në të cilat personeli i sipërpermendur duhet të figurojë.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

- e. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1(një) mjek** në bazë të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ” Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar),

Për mjekun duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diplomë.
- Urdhër Mjeku.
- Listepagesat e shoqërise për të pakten gjashtë muajt e fundit në të cilat mjeku i sipërpermendur duhet të figurojë.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për

masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)

- f. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës të specialistë të kualifikuar si më poshtë:

EMERTIMI	
Teknik të mesëm ndërtimi	(2 persona)
Teknik i mesëm topograf/gjeodet	(2 persona)
Teknik i mesëm hidraulik	(1 person)
Teknik i mesëm mekanik	(1 person)
Teknik kimi industriale	(1 person)
Teknik i mesëm pyjesh (për mbjelljen e bredhave dhe pemeve dekorative)	(1 person)
Manovratore mjetesh te renda (Eskavatorist me goma)	(1 person)
Manovratore mjetesh te renda (Eskavatorist i thjeshte)	(4 persona)
Manovratore mjetesh te renda (Buldozerist)	(2 persona)
Manovratore mjetesh të renda (Automakinist)	(3 persona)
Shoferë	(5 persona)
Hidraulikë	(2 persona)
Mekanik	(1 person)
Specialistë ndërtimi	(5 persona)
Hidroizolues	(2 persona)
Hekurthyes	(1 person)
Murator	(1 person)
Saldator	(2 persona)
Pllakashtrues	(2 persona)
Karpentier	(2 persona)

Për secilin specialist duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Dëshmi kualifikimi profesionale, diploma ose certifikata, lëshuar nga institucione të licensuara nga organet përkatëse.
- Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten gjashte muajt e fundit ne te cilat specialistet e siperpermendur duhet te figuroje.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Për Teknik të mesëm duhet të paraqiten edhe:

- Diploma ose dëshmi e përfundimit të kualifikimit arsimor përkatës.
- Çertifikatë për trajnimin si përgjegjes i sigurisë në kantjer i mbështetur në legjislacionin shqiptar për sigurinë në punë, lëshuar nga një organizëm certifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombëtar ose ndërkombëtar.

Për manovratorët të paraqitet edhe:

- Dëshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të renda të ndërtimit dhe punimeve në tokë e lëshuar nga DPSHTRR.
- Në rastin kur makineritë dhe pajisjet disponohen me qera, Shoferët dhe Manovratorë mjetes të renda, mund të disponohen nga operatori/et ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit, për të cilët nuk është e nevojshme të jenë në listëpagesat e shoqërisë.

g. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik minimalisht:

- 1 (nje) inxhinier dhe 2 (dy) punonjës që të disponojnë certifikatë trajnimi "Për punime në prani uji", lëshuar nga një organizëm certifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombëtar ose ndërkombëtar dhe i regjistruar pranë drejtorisë së akreditimit, në mënyrë që të kuptojnë dhe të ndjekin procedurat e punimeve.
- 1 (nje) inxhinier dhe 2 (dy) punonjës që të disponojnë certifikatë trajnimi "Për punime në lartësi" lëshuar nga një organizëm certifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombëtar ose ndërkombëtar dhe i regjistruar pranë drejtorisë së akreditimit, në mënyrë që të kuptojnë dhe të ndjekin procedurat e punimeve.
- 1 (nje) specialist të pajisur me certifikatë trajnimi për ngjitjen e tubave HDPE, PE, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) specialist i pajisur me certifikatë trajnimi për testimin e tubave nën presion HDPE, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (nje) punonjës që të disponojnë certifikatë trajnimi "Specialist për materialet izoluese dhe punimet me to" lëshuar nga një organizëm certifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombëtar ose ndërkombëtar dhe i regjistruar pranë drejtorisë së akreditimit, në mënyrë që të kuptojnë dhe të ndjekin procedurat e punimeve.
- 1 (nje) punonjës që të disponojë certifikatë trajnimi "Specialist për punime gjelbërimi (kultivim, mbjellje të pemëve dhe shkurreve)" lëshuar nga një organizëm certifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombëtar ose ndërkombëtar dhe i regjistruar pranë drejtorisë së akreditimit, në mënyrë që të kuptojnë dhe të ndjekin procedurat e punimeve.

Për secilin punonjës duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diplome ose certifikate.
- Listëpagesat e shoqërisë për të pakten gjashtë muajt e fundit në të cilat specialistet e sipërpermendur duhet të figurojë.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

- h. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar për të paktën **80 (tetëdhjetë)** punonjës për gjashtë muajt e fundit.
Per kete te paraqitet:
- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për të paktën periudhën e 6 muajve të fundit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- a. Operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet te jenë në përputhje me objektin e prokurimit:
- | | |
|---|-------------------|
| • ISO 9001:2015 | (ose ekuivalente) |
| • OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 | (ose ekuivalente) |
| • ISO 14001-2015 | (ose ekuivalente) |
| • PAS 99-2012 | (ose ekuivalente) |
| • ISO 1452-1:2009 | (ose ekuivalente) |
| • ISO 3834-2:2005 | (ose ekuivalente) |
| • ISO 39001:2012 | (ose ekuivalente) |

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente), në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

- b. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me lejet dhe licencat si më poshtë:

- Leje Mjedisi te tipic C, Kodi III.1.A “Per trajtim/magazinim (stacionim) ose trajtim i mbetjeve”.
- Licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2.A (1+2), “Për auditim mjedisor dhe ndikimin në mjedis”.
- Licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, transportim të mbetjeve”.
- Liçensa përkatëse të lëshuar nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) me Kod III.7.A Studim, projektim dhe zbatim në fushën e pyjeve dhe kullotave, Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe / ose kullotat.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

- c. Operatori ekonomik ofertues për materialet:

- **Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm,**
- **Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm,**
- **Panele Sanduic,**
- **Rrjete teli,**
- për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi autorizim prodhuesi, ose distributori të autorizuar, ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit **ose** midis **ofertuesit -distributor-prodhues**. Në autorizim të jepen të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.
- Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.
(Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .)

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Për materialet:

- **Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm,**
- **Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm,**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet ose certifikatat e testimit EN 10204 sipas metodës EN 13476 ose ekuivalente (*Për tuba Plastik, për sistemet e kanalizimeve nëntokësore*) nga prodhuesi ose nga laboratorë të certifikuar nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit.

Për materialet:

- **Rrjetë teli**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet/certifikatat e testimit nga prodhuesi ose nga laboratorë të certifikuar nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit sipas standarteve:

EN 10223-3 ose ekuivalente përsa i përket thurjes së rrjetës apo gardhit të telit;

EN 10218-2 ose ekuivalente përsa i përket tolerancës dhe dimensioneve të telit;

EN 10244-2 ose ekuivalente përsa i përket zinkimit apo veshjes me zink;

Për pemët:

- **Bredh me $d > 10$ cm**
- **Pemë dekorative**

- për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi autorizim prodhuesi, ose distributori të autorizuar, ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit **ose** midis **ofertuesit -distributor-prodhues**. Në autorizim të jepen të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.
 - Operatori ekonomik ofertues nëse nuk është prodhues duhet të paraqesë nga prodhuesi ose distributori Çertifikate fitosanitare & origjine për bimët.
- (Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .)

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

2.3.5 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, kerkohen si me poshte:

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Autobus per transport puntoresh e stafi	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7 -10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
Kamion me vinç me krahë me kapacitet mbajtës 10-20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 3
Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Cope 1
Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 4
Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
Minifadrome me goma (bobcat apo ekuivalente)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul hekur-hekur	në pronësi ose me qira	Copë 2
Rrul gome-hekur	në pronësi ose me qira	Copë 2
Rrul gome-gome	në pronësi ose me qira	Copë 1
Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 3
Depozite uji deri në 5000 litra	në pronësi ose me qira	Copë 2
Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 5
Paisje për hekurthyes (tranxhe/elektrobango)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Paisje niveluese për nivelim shtresash (helikopter)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Ngjeshës	në pronësi ose me qira	Copë 2

Dokumenta Standarde të Tenderit

Pompë uji	në pronësi ose me qira	Copë 4
Pompë presioni për testimin e tubave nën presion	në pronësi ose me qira	Copë 2
Sistem Wellpoint/ekuivalent për heqje ujërash dhe mbetjeve të hidrokarbureve (shoqëruar me foto)	në pronësi ose me qira	Copë 2
Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Copë 4
Betoniere me kapacitet mbi 0.3 m3	në pronësi ose me qira	Copë 4
Betonforma	në pronësi ose me qira	Min 200m2
Total station për matje topografike ose GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator	në pronësi ose me qira	Copë 3
Saldatrice / motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Cope 2
Motorsharre me benzine për prerjen e pemëve të imëta	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kulle/ballonë ndricimi	në pronësi ose me qira	Copë 2
Nyje inertesh	në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi (noteriale)	Copë 1
Nyje prodhim betoni	në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi (noteriale)	Copë 1
Fabrike asfalti	në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi (noteriale)	Copë 1

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 80 copë
 - Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë
- Eshte e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.10 dhe dokumentacioni si më poshte:
- *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
-Për autobuzin duhet të paraqitet dhe leje transport udhëtarësh dhe siguracion pasagjerësh.(të vlefshme).
 - *Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), duhet të shoqerohet me kontratën perkatese noteriale të qerash/furnizimit të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
 - *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*
 - *Për nyjen e prodhimit të inerteve, nyjen e prodhimit të betonit dhe fabriken e prodhimit të asfaltit të paraqitet leje mjedisore leshuar nga QKL Kodi. III.1.B. Leja mjedisore do të paraqitet edhe në rastin e kontratave të furnizimit.*

- *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

2.3.6 Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkuara në piken 2.3.5 të Kapcitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të hedhur në tender të shprehur sipas afatit kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim, kjo bazuar në VKM Nr. 514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të asfaltit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12697-2:2015, SSH EN 12697-34:2012, SSH EN 12697-6:2012, SSH EN ISO 12697-5:2012.

Persa me sipër duhet të paraqitet:

- Kontrata noteriale me laboratorin testues perkates
- Certifikata e akreditimit të laboratorit testues perkates

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892-1:2016.

Persa me sipër duhet të paraqitet:

- Kontrata noteriale me laboratorin testues perkates
- Certifikata e akreditimit të laboratorit testues perkates

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Materialet bashkelidhur DST-ve jane ngarkuar ne sistemin elektronik te prokurimit si dokument me vete.

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Materialet bashkelidhur DST-ve te ngarkuara ne sistemin elektronik te prokurimit si dokument me vete.

Grafiku i Punimeve: eshte ngarkuar ne sistemin elektronik te prokurimit si dokument me vete.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Preventivat e punimeve pa cmime janë ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit si dokument me vete.

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/ Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkonsulentit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkonsulentin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkonsulentin një dispozitë që premtë ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prona tjetër sipas kontratës.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
